Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Terezë", Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne e kemi kualifikuar opinionin e auditimit për pasqyrat financiare për shkak të gabimeve materiale të prezantuara në vijim:

A1 Raportimi i pasurisë jo financiare në PFV nuk ishte i plotë, ngase Ministria nuk i kishte regjistruar blerjet kapitale prej 820,349€ në SIMFK dhe blerjen e pasurive nën 1,000€ prej 26,814€ në sistemin E-pasuria. Rrjedhimisht, këto nuk janë raportuar në PFV.

A2 Nuk kemi marrë dëshmi audituese për pasurinë kapitale të regjistruara në vitet e mëhershme në vlerë neto prej 1,138,365€. Pasuritë në vlerë neto kontabël prej 12,725€ janë në regjistrat e pasurisë së Ministrisë, ndërsa është dashur të shlyhen pasi që janë tjetërsuar.

A3 Pasuria me vlerë neto kontabël në vlerë prej 70,686€ ishte regjistruar si investim në vijim, ndërsa është dashur të regjistrohet si pasuri në përdorim. Për pasuritë prej 441,251€, zyrtarët e ministrisë nuk ishin në gjendje të dëshmojnë se si është përcaktuar vlera financiare e këtyre pasurive.

A4 Nuk kemi mundur të bëjmë ekzaminimin fizik të një veture.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Ministria nuk kishte regjistruar pasuritë kapitale të blera në vitin 2020 në vlerë prej 820,349€ dhe blerjen e pasurive jokapitale (nën 1000€) në vlerë 26,814€, ashtu siç kërkohet sipas nenit 6, pika 3 e Rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit; dhe

B1 Komisioni i invertarizimit nuk e kishte përfunduar invertarizimin e pasurisë si dhe nuk kishte hartuar raportin e përgjithshëm para përgatitjes së PVF-ve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të

shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Financave, Punës dhe i Transfereve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur më poshtë në Grafikun 1). Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike[4]



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. Për detajet shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos regjistrim i pasurive kapitale në SIMFK dhe pasurive nën 1000€ në sistemin e-pasuria, si dhe mos raportim i tyre në PFV

Gjetja

Sipas nenit 6, pika 3 e Rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Më tutje, sipas nenit 19 pika 2 e Rregullës MF 01/2017 për raportim vjetor financiar të Organizatave Buxhetore, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të regjistrojnë vlerën e pasurive jo financiare në regjistrat kontabël sipas rregullores përkatëse për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Nga testimet tona të pasurisë, ka rezultuar se pasuritë kapitale të blera në vitin 2020 në vlerë prej 820,349€, nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive (SIMFK) të MPMS-së si dhe blerjet nën 1000€ në vlerë prej 26,814€ nuk ishin regjistruar në e-pasuria. Këto pasuri nuk ishin prezantuar as në PFV, duke e nënvlerësuar vlerën e tyre të shpalosur për këto shuma.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme joadekuate në lidhje me regjistrimin dhe raportimin e pasurisë. Mos regjistrimi i blerjeve ishte ndikuar edhe nga ndryshimet në pozitën e zyrtarit të pasurisë, i cili këto regjistrime i kishte bërë në vitin 2021.

Ndikimi

Mos evidentimi i pasurive në regjistrat kontabël ka reflektuar në nënvlerësim të vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël dhe njëherësh ka rezultuar në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV. Mos regjistrimi i pasurisë, rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive dhe raportimin e tyre në PFV, në mënyrë që të krijohet regjistri i saktë dhe i plotë të pasurisë dhe raportimi i drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e dokumenteve burimore të pasurisë dhe mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë

Gjetja

Sipas Nenit 6 të Rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Lidhur me menaxhimin e pasurive ne kemi vërejtur si në vijim:

- Për 20 nga 70 mostrat e testuara të pasurive, me vlerë të përbashkët prej 1,138,365€, e të cilat janë të paraqitura në regjistrin e pasurisë kapitale, MPMS nuk ka ka qenë në gjendje të na ofrojë dokumentacion burimor mbështetës për to. Këto pasuri ishin të regjistruara në vitet e mëhershme (kryesisht nga viti 2006);

- Gjashtë vetura me vlerë kontabël të mbetur 3,100€, të shitura me ankand përmes Ministrisë së Administratës Publike (MAP) në vitin 2018 nuk ishin shlyer nga regjistri i pasurisë. Ministria kishte bërë kërkesën në MF për shlyerje të pasurisë, mirëpo në mungesë të dokumentacionit të plotë, MF nuk kishte bërë shlyerjen e këtyre veturave nga lista. Arsyetimi i MPMS-së për mungesë të plotë të dokumentacionit për shlyerje ishte për shkak se procedurat e ankandit ishin zhvilluar nga MAP. MPMS nuk kishte bërë përpjekje të mëtutjeshme që në bashkëpunim me MAP të siguroj dokumentacionin e plotë dhe t'i shlyej nga regjistri;

- Dy vetura (me vlerë të mbetur kontabël 1,800€) ende figurojnë në regjistrat e pasurisë së Ministrisë, edhe pse nuk janë në pronësi të Ministrisë. Njëra ishte dhuruar me vendim të drejtorit të Entit Special Shtime (datë 29.06.2005) Shoqatës së të Burgosurve Politik të Kosovës, ndërsa tjetra me Marrëveshje të mirëkuptimit i është dhuruar komunës së Zubin Potokut (datë 30.06.2016) për bartjen e kompetencave shërbimeve sociale në nivel komunal;

- Në dy raste kemi vërejtur se pasuritë kapitale mbi 1000€ në vlerë prej 9,625€ nuk janë pasuri e Ministrisë. Kjo gjendje ka ardhur për shkak se Ministria nuk kishte bërë bartjen e pasurisë tek Komunat përkatëse ku në vitin 2017 kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë.

Mangësitë e lartëcekura kishin ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta në ruajtjen e dokumentacionit të pasurisë dhe angazhimit të pamjaftueshëm të zyrtarit të pasurisë për të bërë azhurnimin e regjistrit të pasurive.

Ndikimi Mungesa e dokumenteve mbështetëse për pasuritë e paraqitura në regjistër kontabël dhe mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo të tjetërsohet si dhe vlera e pasurisë së organizatës e paraqitur në pasqyra financiare të mos jetë e saktë.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë, në mënyrë që për tërë pasurinë të ketë dokumentacion mbështetës. Po ashtu, në bashkëpunim me MAP dhe MF duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe pasuritë që nuk janë pronë e Ministrisë duhet të shlyhen sipas kërkesave të rregullores.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në klasifikimin dhe vlerësimin e pasurive ekzistuese

Gjetja Sipas nenit 11.3 të Rregullorës për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, precizohet se pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim, ndërsa nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi. Neni 13 i kësaj rregulloreje, thekson se në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Neni 6.4 thekson se Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të themelojë regjistër kontabël të pasurive jo financiare ku, përveç informatave të kërkuara nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, do të përfshihet edhe vlera fillestare ose e vlerësuar e pasurisë.

- Në tri mostra të testuara me vlerë totale prej 70,686€, Ministria ende nuk kishte filluar aplikimin e zhvlerësimit përkundër se këto projekte kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi i tyre teknik. Fjala është për rastet si vijon: (a) Projekti ideor i Qendrës për Aftësim Profesional-Gjakovë me vlerë 38,818€; (b) Renovimi i kulmit Qendrës për Aftësim Profesional-Ferizaj me vlerë 26,156€ dhe (c) Projekti ideor ZKP-Ranillug" me vlerë 5,712€. Këto pagesa nuk u janë mveshur shpenzimeve tjera të projekteve për tu kapitalizuar, mirëpo ishin klasifikuar në regjistrat e pasurisë si investime në vijim.

- Për katër objekte me vlerë 441,251€ në regjistrat e pasurisë (Qendra e Aftësimeve profesionale në Prizren, Qendra Regjionale e Punësimit në Prizren, Objekti Ekzistues Ferizaj – Qendra e Aftësimit Profesional, dhe Qendra Regjionale e Punësimit në Prizren), të regjistruara në vitin 2006 dhe 2010, edhe pse na janë siguruar regjistrat e kadastrit për to, nuk na është ofruar dëshmia për mënyrën e përcaktimit të vlerës financiare.

Dobësitë e theksuara më lartë kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe mungesës së procesit të vlerësimit nga Komisioni profesional i vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Klasifikimi jo adekuat i pasurive jo financiare shkakton mangësi në raportim të informatave rreth pasurive, ndërsa moszhvlerësimi dhe mungesa e procesit të vlerësimit të duhur financiar ndikon në nën/mbivlerësimin e vlerës së pasurisë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë se për të prezantuar pamje të drejtë të informatave të pasurive, regjistri i pasurisë të azhurnohet në baza të rregullta, duke i respektuar të gjitha procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë. Më tutje, duhet të siguroj formimin e një Komisioni profesional të vlerësimit të pasurive në mënyrë që të gjitha pasuritë e regjistruara të reflektojnë vlerën e saktë në regjistrin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Pamundësi e ekzaminimit fizik të pasurisë

Gjetja Sipas Nenit 2 të Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Për të konfirmuar ekzistencën fizike të pasurive, ne kemi bërë ekzaminimin fizik të 15 veturave të përzgjedhura për testim, ndërsa në një rast zyrtarët e Ministrisë nuk ishin në gjendje të identifikojnë vend ndodhjen e veturës (Vetura KIA me nr. të shasisë KNAJA526525146969 me vlerë neto zero).

	Kjo kishte ndodhur për shkak të moskoordinimit të duhur në mes logjistikës dhe zyrtarit të pasurisë si dhe mos invertarizimit/ harmonizimit të pasurisë me bazën e pasurive të vitit 2020.
Ndikimi	Pamundësia e ekzaminimit fizik të veturave, rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo të tjetërsohet duke ndikuar në mos paraqitjen e saktë të vlerës së pasurisë në PFV.
Rekomandimi A4	Ministri duhet të marrë masa për forcimin e kontrolleve në mirëmbajtjen e regjistrit të pasurisë dhe të inicojë një analizë gjithëpërfshirëse të veturave në mënyrë që të sigurohet se të gjitha pasuritë e regjistruara ekzistojnë fizikisht dhe janë nën kontrollin e Ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Dobësitë në invertarizimin dhe vlerësimin e pasurisë jo financiare

Gjetja

Neni 19.4.7 i Rregullorës për menaxhimin e pasurisë jo financiare thekson se hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Ndërkaq, neni 20 thekson se Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiare për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës.

Gjatë ekzaminimeve tona të auditimit të pasurive jo kapitale, ne kemi vërejtur se Ministria edhe këtë vit nuk kishte bërë progres në inventarizimin e pasurisë, pasi që ZKA kishte formuar komisionin për inventarizim të pasurive, mirëpo i njëjti nuk kishte përfunduar detyrën dhe nuk kishte hartuar raportin e përgjithshëm për inventarizim të pasurisë para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Si rrjedhojë e kësaj, nuk ishte bërë as vlerësimi i pasurisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime të mëtutjeshme për të përfunduar inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë së Ministrisë, proces ky i cili nuk ishte përfunduar nga Komisioni përkatës.

Ndikimi

Mos inventarizimi si dhe mos vlerësimi i pasurive jo financiare reflekton në mbi/nënvlerësim të gjendjes së pasurisë. Kjo rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë që komisioni për invertarizimin e pasurisë të përfundoj punën e tij para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe të bëj barazimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara, duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 550,375,929€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 547,912,935€. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve përbën 98% të shpenzimeve të përgjithshme të Ministrisë, që kanë të bëjnë kryesisht me skemat pensionale dhe sociale.

Me rastin e ekzaminimit të pagesave sipas të gjitha skemave pensionale dhe atyre sociale, ne kemi identifikuar një shumë totale të pagesave në shumën prej 1,451,319€ të paguara jashtë kritereve të përcaktuara ligjore apo pa një bazë të qartë ligjore. Se për çfarë qëllimesh janë kryer këto pagesa, më hollësisht do të shpjegohen në vijim të këtij raporti.

Pra, kemi zhvilluar procedura analitike substanciale krahasuese për skemat pensionale dhe sociale, ndërsa për pjesën tjetër të subvencioneve dhe transfereve që nuk është e aplikueshme kjo metodë, kemi testuar 7 mostra për teste substanciale në vlerë 4,825,885€ dhe për qëllime të pajtueshmërisë kemi testuar 236 mostra.

Konkluzionet e auditimit janë se menaxhimi i këtyre skemave ende mbetet sfidë mjaft e vështirë, me theks të veçantë tek përfituesit e dyfishtë, si dhe pagesat e pensioneve për personat e punësuar.

Çështja B2 - Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve

Gjetja

Sipas nenit 10.4.2 të ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti, pensionet e parakohshme “Trepça” ndërpriten së paguari, nëse personi punësohet apo vetëpunësohet. Më tutje, sipas nenit 16.4 të ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së - Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit, si dhe sipas nenit 4.4 të ligjit Nr.04/L-096 për skemën e ndihmës sociale ndalon të drejtën për ndihmë sociale për persona të punësuar.

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve.

a) Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar - Nga krahasimi i të dhënave të MPMS-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së, kemi vërejtur se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit financiar për vitin 2020 ishte 254,478€.

Tabela 1. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar (në euro)

Nr.	Lloji i skemës	Numri i pagesave	Gabimi Financiar (€)
1	Ndihma Sociale	356	61,695
2	Pensionet Trepça	134	16,884
3	DFDIL - Veteran	1,001	175,899
Gjithsej		**1,491**	**254,478**

b) Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve - Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MPMS dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil kemi gjetur se gjatë vitit 2020 janë realizuar gjithsej 840 pagesa, në vlerë totale 108,801€ për pensione pas vdekjes së përfituesve.

Tabela 2. Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve (në euro)

Lloji i pensionit (Skemës pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2020		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2020		Gjithsej pagesat pas vdekjës së përfituesve	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
Skema e të verbërve	1	250	13	3,000	**14**	**3,250**
Pensionet Bazë	90	9,060	465	46,800	**555**	**55,860**
Pensionet Kontributive	8	2,497	128	26,009	**136**	**28,506**
Pensionet për persona me aftësi të kufizuar (PPAK)	5	885	41	4,155	**46**	**5,040**
Pensionet e parakohshme të Trepçës	-	-	5	630	**5**	**630**
DFDIL Veteran	29	4,930	38	6,460	**67**	**11,390**
Pensionet për paraplegjikët dhe tetraplegjikët (PPTP)	-	-	17	4,125	**17**	**4,125**
Totali	**133**	**17,622**	**707**	**91,179**	**840**	**108,801**

Pagesat për përfituesit që janë të punësuar kanë ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme të krijuara nga rrethanat e pandemisë dhe për shkak të korigjimeve të pagave nga bizneset në fund të vitit 2020 për muajt paraprak për të cilat Ministria nuk mund t'i kishte nën kontroll.

Ndërsa, pagesat pas vdekjes së përfituesve edhe pse me tendencë të rënies së gabimit financiar nga viti i kaluar kanë ndodhur ngase lajmërimi i pensionistëve ishte ndërprerë nga muaji mars 2020 dhe vdekjet e përfituesve, për shkak të rrethanave të krijuara të pandemisë Covid 19, nuk ishin regjistruar me kohë në ARC. Për këto raste nuk ishte në dijeni Ministria.

Ndikimi Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dhe mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave janë pagesa të parregullta, dhe si të tilla dëmtojnë buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër si dhe ta konsultoj zyrën ligjore nëse ka bazë ligjore për kthimin e këtyre pagesave nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, të bëj krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK dhe regjistrit civil, si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Pagesat pa bazë të qartë ligjore lidhur me pensionet e dyfishta

Gjetja Ligji Nr.04/L -131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, rregullon pensionet bazë të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës. Sipas nenit 16 të këtij ligji, personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave të përcaktuara me këtë ligj në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen nga shteti.

Sipas ligjit Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre - neni 5.1.4 përfituesit e pensioneve familjare, invalidor personal dhe invalidor familjar nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë.

Sipas ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së neni 16 pika 2, Veteranët e UÇK-së nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti . Nëse veterani është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti duhet të përcaktohet se cilin pension do ta marrë.

Sipas ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 5.3 përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që u takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe sociale kemi identifikuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë 1,088,040€ për përfitues

të cilët gëzojnë më shumë se një pension. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së, të cilat pagesa Ministria kishte kryer edhe vitin e kaluar bazuar në vendimin e ish Kryeministrit nr. 12/82 të datës 28.12.2018. Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK dhe ish-pjesëtarët e TMK-së deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale. Krahasuar në vitin e kaluar, ka një rritje të lehtë të shumës së këtyre pagesave.

Tabela 3. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

Lloji i skemës	Numri i pagesave	Gabimi financiar në €
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL-Familjar	847	212,940
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe DFDIL-Veteran	-	-
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL-Familjar	3,948	864,848
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL-Veteran	14	1,768
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL-Familjar	24	2,340
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL-Veteran	18	1,855
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL-Familjar	2	546
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL-Veteran	1	198
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL-Familjar	-	-
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL-Veteran	1	3,455
DFDIL–Familjar dhe PIP	1	90
Trepça-DFDIL-Veteran	-	-
KV–DFDIL-Familjar	-	-
Totali	**4,856**	**1,088,040**

Mos harmonizimi i legjislacionit për skemat pensionale dhe vazhdimi i pagesës së pensioneve të dyfishta edhe gjatë vitit 2020 ka ndodhur për shkak se Menaxhmenti nuk kishte inicuar procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale shkaku i rrethanave të pandemisë dhe shpërndarjes së Ministrisë.

Ndikimi Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë janë në kundërshtim me ligjin dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B3	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në MPMS, përbëhet nga katër auditorë dhe udhëhiqet nga drejtori. Për vitin 2020, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar që t'i kryente 20 auditime të rregullta dhe dy auditime sipas kërkesës.
Deri në fund të vitit 2020, për shkak të pandemisë dhe ri-strukturimit të Ministrisë, NjAB kishte arritur të finalizonte gjithsej 14 auditime që i përkasin sistemeve me rrezik të lartë duke përfshirë shumicën e njësive organizative të Ministrisë e që kanë të bëjne me skemën e ndihmës sociale, pensionet bazike dhe kontributive, pensionet e paaftësisë së përhershme, skemën e FSK-së, të hyrat, logjistikën në Trupën Ekzekutive në Inspektoratin e Punës, përdorimin e automjeteve zyrtare, derivateve & servisimin e tyre, burimet njerëzore dhe financat. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB në masë të madhe përfshinte vitin 2020. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 65 rekomandime. Prej tyre 60 ishin zbatuar, 3 ishin në proces dhe 2 të pazbatuara.

Çështja A5 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja	Sipas Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 20 për Komitetin e Auditimit në sektorin publik, të gjitha subjektet e sektorit publik obligohen që të themelojnë Komitetin e Auditimit në përputhje me dispozitat e përcaktuara me këtë ligj. Ndërsa sipas nenit 6 (Përbërja dhe mandati i Komitetit të Auditimit), Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Komiteti i auditimit nuk ka qenë funksional gjatë vitit 2020, për arsye se Kryesuesi i Komitetit kishte dhënë dorëheqje, ndërsa njëri anëtar kishte munguar për shkaqe shëndetsore. Kjo ka ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve nga ana e menaxhmentit për emërimin e anëtarëve të rinj të Komitetit të auditimit.
Ndikimi	Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.
Rekomandimi A5	Ministri duhet të siguroj themelimin e Komitetit të Auditimit siç parashihet me Ligjin nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe udhëzimin administrativ MF nr 01/2019 për themelimin dhe funksionin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Më poshtë janë prezantuar çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm për qëllime të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështja 1	**Mos paraqitja e duhur e buxhetit fillestar të shpenzimeve në PVF**
Gjetja	Në raportin vjetor financiar për vitin 2020, më konkretisht në Raportin e ekzekutimit të buxhetit (*Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale Neni 14*) ishte prezantuar gabimisht buxheti fillestar i daljes së parasë së gatshme në vlerë prej 481,075,410€, ndërsa Ministria nuk kishte buxhet fillestar të shpenzimeve për vitin 2020, si rezultat i shpërndarjes së Ministrisë.
Veprimi i kërkuar	Ministri në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar duhet të aplikojnë veprime konkrete në forcimin e kontrolleve të brendshme me rastin e përpilimit të PFV-ve, në mënyrë që të sigurohet se ato prezantojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë në mënyrë që të mos rezultojnë në modifikimin e opinionit.
Rezultati	MPMS, pas komunikimit tonë për përmirësim, kishte bërë korrigjimet e nevojshme në Raportin e ekzekutimit të buxhetit, brenda afatit të lejuar për korrigjime. Pasqyrat Financiare Vjetore të korrigjuara janë përgatitur mirë dhe në pajtim me kërkesat ligjore për raportim vjetor financiar të Organizatave buxhetore.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[5]	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**0.00**	**559,321,978.24**	**555,269,123.75**	**499,323,508.41**	**441,839,079.83**
Grante Qeveritare – Buxheti	0.00	530,886,342.72	526,979,216.02	498,235,042.26	441,479,041.17
Financimi përmes huamarrjes	0.00	28,240,110.50	28,240,110.50	0.00	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	0.00	0.00	699,674.46	0.00

Donacionet e jashtme	0.00	195,525.02	49,797.23	388,791.69	360,038.66

Ministria për vitin 2020 nuk kishte buxhet fillestar për shpenzimet për shkak të shpërndarjes së Ministrisë me Ligjin nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, ndërkaq me Ligjin e rishikuar te buxhetit ishte bërë riorganizimi i sërishëm i Ministrive duke i ndarë MPMS-së buxhetin si Ministri e veçantë. Burimet e financimit të buxhetit final përbëhen nga granti qeveritar prej 530,886,343€, financimi përmes huamarrjes prej 28,240,111€ dhe nga donacionet e jashtme prej 195,525€.

Në vitin 2020 MPMS ka shpenzuar 99.3% të buxhetit përfundimtar ose 559,269,124€, ngjajshëm si me vitin paraprak.

Shpjegimet lidhur me zbatimin e buxhetit dhe të pozicionit aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**0.00**	**559,321,978.24**	**555,269,123.75**	**499,323,508.41**	**441,839,079.83**
Pagat dhe mëditjet	0.00	5,089,385.33	5,089,385.33	5,158,821.68	5,085,866.70
Mallrat dhe shërbimet	0.00	1,475,238.22	1,241,261.15	1,946,664.24	1,780,499.16
Komunalitë	0.00	240,340.59	205,192.88	315,803.44	289,864.03
Subvencionet dhe transferet	0.00	550,375,929.42	547,912,935.35	489,340,110.82	433,997,242.94
Investimet Kapitale	0.00	2,141,084.68	820,349.04	2,562,108.23	685,607.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final i pagave dhe mëditjeve prej 5,089,385€ ishte reflektim i ndarjës së buxhetit me rishikim prej 5,192,652€, shkurtimeve buxhetore nga Ministria e Financave prej 166,897€ dhe në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 08/50 datë 21.12.2020 janë ndarë mjetet nga granti qeveritar në fondin e huamarrjes në vlerë prej 63,630€ për programin e Rimëkëmbjes ekonomike (projekti 0099-Covid);


• Buxheti final për mallra dhe shërbime në vlerë prej 1,475,238€ ishte si rezultat i ndarjes të buxhetit me rishikim prej 1,403,823€, ndarjes së mjeteve me vendime të Qeverisë prej 18,330€, dhe përfshirjes së granteve prej 53,080€. Shpenzimet në këtë kategori ishin rreth 84% të buxhetit. Kjo për arsye të ri strukturimit të Ministrisë dhe për shkak të pandemisë;

• Buxheti final për shpenzime komunale prej 240,341€ ishte si rezultat i ndarjes së buxhetit me rishikim për 218,065€ dhe kursimeve buxhetore nga MF në fund të vitit për 22,276€. Ekzekutimi i buxhetit ishte rreth 85.4%;


• Buxheti final për subvencione dhe transfere prej 550,375,929€ ka të bëj me ndarjen e buxhetit me rishikim prej 471,677,632€, ndarjes së mjeteve prej 50,380,450€ me vendime të Qeverisë dhe ndarjes së buxhetit nga fondi i huamarrjes (04) prej 28,176,480€ për zbatimin e programit të Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe përfshirjes së donacioneve prej 141,363€. Shpenzimet në këtë kategori ishin rreth 99.5%; dhe

• Buxheti final për investime kapitale ishte 2,141,085€. Kjo ishte si rezultat i ndarjes së buxhetit me rishikim prej 2,583,241€, shkurtimeve buxhetore nga MF-ja prej 443,230€ dhe donacioneve prej 1,076€. Në fund të vitit, MPMS nuk kishte mundur të realizonte më shumë se 38.3% të buxhetit për investime kapitale. Kjo për shkak se mjetet për projektet kapitale kanë mbetur të pashpenzuara deri në shtator të vitit 2020 si rezultat i ristrukturimit të Ministrisë, kur ka filluar Zyra e prokurimit të inicojë procedurat e prokurimit dhe është bërë zotimi i mjeteve, teknikisht nuk ishte e mundur të ekzekutoheshin porositë për shkak të shkurtimeve buxhetore nga MF-ja. Përveç kësaj, për disa projekte punimet ishin ndalur për shkak të situatës pandemike si dhe për disa projekte tjera nuk ka pasur kërkesa për inicimin e procedurave të prokurimit nga njësia kërkuese.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Ministria në vitin 2020 ishin 328,909€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga Inspektorati i Punës dhe licencat për aktivitetet individuale dhe shërbime profesionale nga Agjencia e Punësimit. Të hyrat tjera në vlerë prej 44,833€ kanë të bëjnë me të hyrat nga viti i kaluar. Në vitin 2020, MPMS kishte realizuar trefishin e të hyrave të planifikuara me Ligjin e Buxhetit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	**124,482.00**	**103,570.00**	**373,742.83**	**523,964.96**	**653,901.36**
Të hyrat jo tatimore	124,482.00	103,570.00	328,909.79	512,635.84	608,428.86
Të hyrat tjera	0.00	0.00	44,833.04	11,329.12	45,472.50

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka rezultuar në 8 rekomandime kryesore. MPMS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tre (3) rekomandime janë zbatuar; tre (3) nuk janë adresuar ende dhe dy (2) rekomandime ishin të mbyllura (nuk aplikohen). Për më shumë detaje, shih më poshtë Grafikun 4.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit dhe publikimit të konkurseve respektohen kriteret dhe legjislacioni përkatës.	Ministria nuk kishte zhvilluar asnjë aktivitet të rekrutimit të stafit përgjatë vitit 2020 andaj nuk kemi mundur të bëjmë vlerësimin lidhur me implementimin e këtij rekomandimit.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherëve përkatës, që lista e profesioneve të paguar për përfitime	Për kontratën ''Sigurimi ndaj aksidenteve në	I zbatuar

		shëndetësore të jetë në përputhje me kontratën. Po ashtu, në inicimin e kërkesës duhet bërë një analizë e mirëfilltë e profesioneve - punëkërkuesve që do të mbështeten, në mënyrë që mos të ketë devijime nga kushtet e vendosura me kontratë.	punë për praktikantë të cilët do të angazhohen për praktikë në Punë në Kompanitë Private'', menaxhmenti ka marrë veprime duke mos e vazhduar këtë shërbim i cili ka qenë në marrëveshje në mes GIZ dhe MPMS-së i përkrahur nga GIZ. Në buxhetin e Agjencisë së Punësimit nuk është planifikuar ky shërbim për vitin 2020.	
3.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.	Menaxhmenti përkundër përpjekjeve nuk ka mundur t'i eliminoj pagesat e subvencioneve dhe transfereve për ata përfitues që janë të punësuar si dhe pas vdekjes. Shih çështjen B2	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.	Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime lidhur me implementimin e këtij rekomandimi. Edhe këtë vit ka pagesa për pensione të dyfishta. Shih çështjen B3.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të shtojë kontrollet e brendshme të cilat do të ndikojnë në rritjen e shkallës së realizimit të buxhetit në këtë kategori. Dhe se, realizimi projekteve kapitale duhet të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore duke i adresuar barrierat për realizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.	Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale sipas metodologjisë së përditësuar dhe standardeve të azhurnuara të auditimit nuk ndikon në opinionin e auditimit financiar dhe të	Nuk është i aplikueshëm më


			pajtueshmërisë, prandaj rekomandimin e kemi konsideruar si të mbyllur. Shpjegimin lidhur me ekzekutimin e buxhetit për investimet kapitale e kemi dhënë tek kapitulli 3 (Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit).	
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.	Menaxhmenti nuk kishte bërë përpjekje në sigurimin e kontrolleve efektive në fushën e pasurisë pasi që kemi hasur çështje të njejta. Shih çështjen B1.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjen e saktë të detyrimeve kontingjente.	ZKF në përgatitjen e PVF-ve për vitin 2020 kishte vendosur procese efektive lidhur me shpalosjen e detyrimeve kontigjente. Këtë e kemi konstatuar duke verifikuar regjistrin e marrë nga Zyra Ligjore e Ministrisë dhe ajo e prezantuar në PVF, ku një obligim i mundshëm prej 7,083€ i cili ishte paguar përgjatë vitit 2020 nuk ishte prezantuar në shpalosjën e detyrimeve kontigjente në PVF, duke krijuar prezantim të saktë të tyre në PVF.	I zbatuar
8.	Obligimet e	Ministri duhet të sigurojë marrjen e	Këtë vit shuma e	I zbatuar

	papaguara	masave për kryerjen e pagesave me kohë dhe kontrolle të shtuara në menaxhimin e duhur të obligimeve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë të paarsyeshme.	vendimeve gjyqësore kishte rënë në 21,133€ nga 57,995€ sa ishin vitin e kaluar. Menaxhmenti në bashkëpunim me zyrën e financave kishin ndërmarrë veprime lidhur me kryerjen e pagesave me kohë duke shtuar kontrollet në menaxhimin e obligimeve.	

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive dhe raportimin e tyre në PFV, në mënyrë që të krijohet regjistri i saktë dhe i plotë të pasurisë dhe raportimi i drejtë në PFV.
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë, në mënyrë që për tërë pasurinë të ketë dokumentacion mbështetës. Po ashtu, në bashkëpunim me MAP dhe MF duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe pasuritë që nuk janë pronë e Ministrisë duhet të shlyhen sipas kërkesave të rregullores.
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se për të prezantuar pamje të drejtë të informatave të pasurive, regjistri i pasurisë të azhurnohet në baza të rregullta, duke i respektuar të gjitha procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë. Më tutje, duhet të siguroj formimin e një Komisioni profesional të vlerësimit të pasurive në mënyrë që të gjitha pasuritë e regjistruara të reflektojnë vlerën e saktë në regjistrin kontabël.
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të marrë masa për forcimin e kontrolleve në mirëmbajtjen e regjistrit të pasurisë dhe të inicojë një analizë gjithëpërfshirëse të veturave në mënyrë që të sigurohet se të gjitha pasuritë e regjistruara ekzistojnë fizikisht dhe janë nën kontrollin e Ministrisë.
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që komisioni për invertarizimin e pasurisë të përfundoj punën e tij para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe të bëj barazimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara, duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël.
6.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër si dhe ta konsultoj zyrën ligjore nëse ka bazë ligjore për kthimin e këtyre pagesave nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, të bëj krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK dhe regjistrit civil, si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.
8.	Auditimi i	Ministri duhet të siguroj themelimin e Komitetit të Auditimit siç parashihet me Ligjin

	Brendshëm	nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe udhëzimin administrativ MF nr 01/2019 për themelimin dhe funksionin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Bujar Bajraktari, Udhëheqës i Auditimit



Nora Rashiti, Udhëheqëse e ekipit




Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

---

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalni Sekretara - Secretary General's office

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Pajtohem/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Feim Osmani

U.D Sekretar i Përgjithshëm i MPMS-së,

Data: 29.korrik.2021, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.[7] . Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.